



Prishtinë, 01 korrik 2024
Kodi i ZRRE-së: V_2227_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
- Kodin e Matjes së Energjisë Elektrike të OSSH;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_2565_06_24** i dt.27.06.2024;

në seancën e mbajtur më datë 01 korrik 2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZHET** ankesa e konsumatorit “**Bejta Commerce**” SHA, - A.K, nga Komuna e Gjilanit, si në arsyet e paraqitura në këtë vendim.
- II. KESCO** duhet të ofrojë konsumatorit kontrate pagese 12 mujore.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 12.04.2024 ka apeluar Vendimin e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 28.03.2024 dhe 30.04.2024 lidhur me kontestimin e faturës së periudhës janar 2024 dhe korigjimit plotësues nr. 28709DGL-9000108 datë 26.03.2024, për shkak të dyshimit të matjes dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 61575482 dhe njehsorit elektrik nr.51285394.

Me datë 05.09.2023 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për pranimin e grupeve matëse kanë larguar nga matja GM me nr. 51285394 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=02152,886 kWh dhe TU=00103,466 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=03038,491 kVAr dhe TU=00295,832 kVAr me konstantë llogaritëse C=2000, gjendje momentale të Maksigrafit TL=0,3203 dhe TU=0,1762 si dhe kanë vendosur për matje GM nr. 61575482 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=000000 kVAr dhe TU=000000 kVAr, gjendje momentale të Maksigrafit TL=0,3203 dhe TU=0,1762 dhe konstantë llogaritëse C=2000. Ekipi i KEDS-it po ashtu ka evidentuar në procesverbal se behet ndërrimi i pikës matëse-Kalibrim Periodik. Njehsori elektrik dërgohet në shqyrtim dhe se komunikimi me AMR është në rregull si dhe që njehsori është në gjendje të rregullt. Ekipi i KEDS-it po ashtu ka evidentuar të dhënat e tjera teknike të pikës matëse. **Provë:** Procesverbali-Protokoli mbi montimin-demontimin-ndërrimin e grupit matës nr. 0025496 datë 05.09.2023



Me datë 01.02.2024 Departamenti i faturimit ne KESCO ka dërguar konsumatorit faturën e energjisë elektrike per periudhën janar 2024 ne vlerë financiare **3,214.58€** kurse me date 26.03.2024 korrigjimin plotësues ne vlerë **9,044.88 €** per periudhën 09/2022 deri ne periudhën 08/2023 per shkak te faturimit te gabuar te fuqisë se angazhuar(Maksigrafit) me njehsorin elektrik nr.51285394.

Provë: Fatura 01240DGL-9000108 date 01.02.2024 dhe korrigjimi nr. 28709DGL-9000108 datë 26.03.2024

Me datë 08.02.2024 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KESCO duke kërkuar që t'i behet ri shqyrtimi i faturës se periudhës janar 2024 për shkak të dyshimit ne matje, leximit dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 61575482.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KESCO datë 08.02.2024.

Me datë 28.03.2024 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në leximet e AMR, rrjedhës se energjisë elektrike si dhe në Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji kurse me date 30.04.2024 po ashtu i është përgjigjur konsumatorit lidhur me korrigjimin plotësues duke e njoftuar se ky korrigjim është bere per faturat e periudhës 09/2022 deri ne periudhën 09/2023 si rrjedhoje e faturimit te gabuar per shkak te Maksigrafit.

Provë: Përgjigja e KESCO-s e datës 24.10.2017.

Me datë 12.04.2024 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjën e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar që të aprovohet në tërësi ankesa e parashtruar nga ankuesi, që të anulohet Vendimi i lëshuar nga KESCO i dt. 28.03.2024 si dhe që të behet rishqyrtimi i faturës per periudhën janar 2024 kurse me date 03.05.2024 ka plotësuar ankesën edhe me kundërshtimin ndaj vendimit KESCO i dt. 30.04.2024 duke kërkuar qe te anulohet korrigjimi plotësues.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së e datë 12.04.2024 dhe date 03.05.2024

Bordi i ZRRE, duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KESCO-s, ka vërejtur se:

Me datë 05.09.2023 punëtorët e autorizuar të KEDS-it per pranimin e grupeve matëse kanë larguar nga matja GM me nr. 51285394 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=02152,886 kWh dhe TU=00103,466 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=03038,491 kVAR dhe TU=00295,832 kVAR me konstantë llogaritëse C=2000, gjendje momentale te Maksigrafit TL=0,3203 dhe TU=0,1762 si dhe kane vendosur per matje GM nr. 61575482 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=000000 kVAR dhe TU=000000 kVAR, gjendje momentale te Maksigrafit TL=0,3203 dhe TU=0,1762 dhe konstantë llogaritëse C=2000. Ekipi i KEDS-it po ashtu ka evidentuar ne procesverbal se behet ndërrimi i pikës matëse-Kalibrim Periodik. Njehsori elektrik dërgohet ne shqyrtim dhe se komunikimi me AMR është ne rregull si dhe qe njehsori është ne gjendje te rregullt. Ekipi i KEDS-it po ashtu ka evidentuar te dhënat e tjerra teknike te pikës matëse. Bordi i ZRRE-së ka shqyrtuar gjendjen e shpenzimeve te energjisë aktive te faturuar per periudhën gusht 2023 dhe konstaton se ka përputhje plotësisht me gjendjen e shpenzimeve te evidentuara ne procesverbal nga ekipet e KEDS-it

Me datë 01.02.2024 Departamenti i faturimit ne KESCO ka dërguar konsumatorit faturën e energjisë elektrike per periudhën janar 2024 ne vlerë financiare 3,214.58€, ku përfshihet faturimi i energjisë aktive TL=3700 kWh dhe TU=1280 kWh, energjia reaktive TL=9639 dhe TU=4,957 si dhe Fuqia e angazhuar prej 439.80 kW. Bordi i ZRRE-së ka shqyrtuar faturën përfshi edhe leximet çdo 15 minutëshe per fuqinë e angazhuar nga konsumatori per periudhën janar 2024 te nxjerra nga njehsori elektrik dhe konstaton se fatura e periudhës janar 2024 paraqet shpenzimet reale te konsumatorit përkatësisht



faturimi i kësaj periudhe është në përputhje me nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji e ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit”.*

Bordi i ZRRE-së ka shqyrtuar korrigjimin plotësues nr. 28709DGL-9000108 datë 26.03.2024 i cili është bere nga Departamenti i faturimit në KEDS për periudhën 09/2022 deri në periudhën 08/2023 si dhe mënyrën e kalkulimit të këtij korrigjimi për shkak të mos faturimit të saktë të fuqisë së angazhuar për periudhën kontestuese, dhe konstaton se ky korrigjim është në përputhje me nenin 28 paragrafin 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji e ku thuhet se: “Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”. Bazuar në analizat e bëra për faturat e periudhës 09/2022 deri në periudhën 08/2023 vërtetohet se korrigjimi i faturimit është bere vetëm për fuqinë e angazhuar mujore të konsumatorit dhe se të dhënat tjera të nxjerra dhe faturuara nuk kanë ndryshuar. Bordi i ZRRE-së me qellim të vërtetimit të saktë të fuqisë së angazhuar, ka analizuar leximet e nxjerra 15 minuteshe nga njehsori elektrik nr. 51285394 për secilën periudhë mujore dhe konstaton se faturimi i korrigjuar për fuqinë është i saktë. Bordi i ZRRE-së konstaton se faturimi i mëhershëm i konsumatorit, për këtë periudhë kohore si dhe për periudhat e mëshme (nga periudha 02/2017 kur është vendosur për matje njehsori elektrik nr. 51285394 është në kundërshtim me nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji e ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit” pasi që konsumatori për fuqinë e angazhuar është faturuar duke marrë për bazë 1% të energjisë Aktive mujore dhe jo atë realen e cila është regjistruar në njehsorë e që kjo është edhe në kundërshtim me Strukturën tarifore të aprovuar nga ZRRE.*

Bordi i ZRRE-së thekson se, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i ZRRE-së duke pasur parasysh të gjitha faktet e përmendura më lartë, Procesverbali-Protokoli mbi montimin-demontimin-ndërrimin e grupit matës nr. 0025496 datë 05.09.2023, faturën 01240DGL-9000108 date 01.02.2024, korrigjimin nr. 28709DGL-9000108 datë 26.03.2024, si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO,
- Konsumatorit: **A.K - “Bejta Commerce” SHA**, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.